



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/F4-5 Prot.
Nr. Dok.202502613/5

Tiranë 18/12/2025

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të nevojshme për respektimin e afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes penale me të pandehur F.O*

**GJYKATËS SË AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit në muajin prill 2025 është paraqitur ankesa¹ e shtetasit F.O i cili parashtroi se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, për shkak të zgjatjes së afatit të gjyimit të çështjes penale në ngarkim të tij nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

1. Rrethanat e çështjes

Z. F.O prej 13 vitesh ka qenë punonjës i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin Kukës në pozicionin e shoferit. Në vitin 2018 është proceduar penalisht nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për veprat penale të "Kundërshtimit të punonjësit të rendit publik" dhe "Shkatërrimit të pronës", ngjarje këto të ndodhura për shkak të pjesëmarrjes së tij në protestën e Rrugës së Kombit në Kukës.

¹Nr. K2/F4-1 prot., datë 07.04.2025 ankesa e shtetasit F.O

Këto akuza kanë rënë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës me vendimin nr.**-****-****, datë 06.11.2020 ka vendosur: *Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F.O, pasi nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet.*

Ky vendim është ankimuar nga prokuroria në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Nga muaji nëntor i vitit 2020 e deri tani nuk ka asnjë informacion për shqyrtimin e kësaj çështjeje në këtë gjykatë.

Ankuesi pretendon se mosshqyrtimi i kësaj çështjeje brenda afatit ligjor ose të paktën brenda një afati të arsyeshëm, i ka kushtuar atij edhe vendin e punës, duke e humbur atë.

Në vitin 2022, ai parashtroi se Bashkia Kukës e ka larguar padrejtësisht nga puna me pretekstin se nuk ka vërtetim besueshmërie nga policia, ka pengesa ligjore dhe nuk është i përshtatshëm për t'u punësuar në këtë strukturë. Por shtetasi nuk është dënuar me një vendim të formës së prerë. Sipas tij, të vetmet rekorde që ka të shënuara nga policia janë shoqërimi në polici dy herë, një herë për një shoqërim të cilin Prokuroria e Kukësit e ka pushuar dhe rasti i dytë si pjesëmarrës në protestën e Rugës së Kombit për të cilin pritet gjyqimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës e ka shpallur të pafajshëm.

VKM nr.520, datë 25.07.2019² “*Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*”, neni 39 ndër të tjera përcakton: “e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).”

² Neni 39

Kriteret për pranimin e kandidatëve

1. Kandidati për pranimin në nivelin bazë të shërbimit vendor të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit “C”;
- k) Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi “D”, si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

Komisariati i Policisë Kukës me shkresën e datës 10.04.2022 “Vërtetim besueshmërie” rezulton se të dhënat ndaj shtetasit F.O janë të pastra, përveç dy rasteve të shoqërimit nga ana e Policisë së Shtetit. Një rast shoqërimi ka ndodhur në vitin 2017 si i dyshuar për “prishje të rendit dhe qetësisë publike”, por me vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është vendosur pushimi i çështjes në fjalë. Ndërsa rasti tjetër i shoqërimit në polici ka ndodhur në vitin 2018, si i arrestuar nga policia për rastin e protestës së bërë në Rugën e Kombit për vendosjen e traut në Kalimash. Për këtë rast me vendimin nr.***, datë 06.11.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është shpallur i pafajshëm për akuzat e ngritura, por çështja nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Shtetasi shprehet se duke qenë se pafajësia nuk ka marrë formë të prerë, ai vazhdon të jetë peng i padrejtësive nga institucionet e shtetit. Sipas tij, është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe është larguar nga puna. Çështjen lidhur me marrëdhënien e punës e ka paraqitur në gjykatë, ku me vendim të formës së prerë ka përfituar dëmshpërblimin përkatës për shkarkim të padrejtë nga puna.

Nga institucioni i Avokatit të Popullit është trajtuar në vitin 2022 çështja e evidentimit të shtetasit Onuzi si person me precedent nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës. Duke iu referuar nenit 112 “Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit”³, të dhënat e shtetasit F.O në sistemet

³ Neni 112

Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit
(shtuar shkronja “c” e pikës 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime:

1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për:

- a) gjenealitetet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) arsyet e shoqërimit;
- dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit;
- e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi;
- ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.

2. Në rast arrestimi apo ndalimi, policia evidenton për çdo person të dhënat për:

- a) gjenealitetet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) veprën penale për të cilën është arrestuar apo ndaluar;
- dh) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar, të cilat merren në prani të mbrojtësit në rast se personi nuk e refuzon atë;
- e) orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit;
- ë) zyrën e policisë ku është mbajtur;
- f) punonjësin e policisë, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

3. Nga çdo person i arrestuar apo i ndaluar, në çdo rast, policia merr të dhënat e mëposhtme:

- a) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
- b) dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- c) mostra për nxjerrjen e profilit të ADN-së.

elektronike të Policisë së Shtetit janë hedhur bazuar në pikat 1 e 2 të këtij neni. Ndërsa, sipas pikës 6 të po këtij neni, të dhënat nuk mund të fshihen, sepse nuk ka një vendim të formës së prerë. Pasi vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë, ankuesi duhet t'i drejtohet me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për fshirjen e të dhënave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Aktualisht, qytetari kërkon përfundimin sa më parë të gjykimit të çështjes gjyqësore penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi kanë kaluar tashmë mbi 4 vite dhe akoma nuk ka filluar shqyrtimi i saj në këtë gjykatë.

Prej vitit 2022 kur është shkarkuar padrejtësisht nga puna, nga ana e Bashkisë Kukës, dhe deri tani shtetasi nuk është në marrëdhënie pune. Ai është familjar, babai i katër fëmijëve dhe pastërtia e figurës me vendim të formës së prerë është e rëndësishme për punësimin e tij. Nëpërmjet vërtetimit të pagesës së papunësisë të datës 21.03.2025 rezulton se nga data 01.10.2022 deri më datë 01.04.2023 shtetasi F.O është trajtuar më pagesë mujore 17000 lekë.

Pas hetimit administrativ të kryer nga Avokati i Popullit, nëpërmjet shkresës nr.K2/F4-2 prot., datë 08.05.2025 është kërkuar informacion në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo gjykatë me shkresën nr.10715/1 prot., datë 19.05.2025 sqaron se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja penale nr.*****_*****_**_***** sistemi, datë 05.01.2021 regjistrimi, nr.429 akti, me palë ndërgjyqëse:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër

I pandehur: F.O

Objekti: “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik”; “Shkatërrim prone”.

Në short elektronik datë 03.02.2023, çështja e mësipërme i ka rënë për gjykim gjyqtar F.I dhe është në pritje të daljes për gjykim sipas radhës së kësaj kategorie çështjeje.

II. Kuadri ligjor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

4. Punonjësi i policisë me gradë “Nënkomisar” apo më lart ose në rast emergjence dhe në mungesë të një punonjësi të tillë të policisë, punonjësi me gradën më të lartë mund të autorizojë përdorimin e forcës, sipas këtij ligji, për të realizuar kërkesat e pikës 3, të këtij neni, nëse personi i arrestuar apo i ndaluar kundërshton kërkesën.

5. Për personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia krijon bankën qendrore për regjistrimin e të dhënave të mbledhura.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron dhe kontrollon fshirjen e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, të cilat i merren personit të arrestuar apo të ndaluar, mbi bazën e kërkesës së tij, nëse çështja penale në ngarkim të tij pushohet apo ai shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

7. Afati i ruajtjes së të dhënave të mbledhura në zbatim të këtij neni përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Sipas nenit 42 të Kushtetutës: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik **brenda një afati të arsyeshëm** nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”*

Në Kodin e Procedurës Penale në nenin 4 përcaktohet: *“I pandehuri prezumohet i pafajshëm, gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. 2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.”*

Në nenin 34/a të Kodit të Procedurës Penale⁴ parashikohen të drejtat e të pandehurit ose personit nën hetim.

Çështja e mësipërme ka mbi 4 vjet e regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk është marrë në shqyrtim.

Nga institucioni ynë është konstatuar se vakancat e theksuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pas reformës në drejtësi dhe vënies në zbatim të hartës së re gjyqësore, kanë bërë që të akumulohet një numër tepër i lartë i dosjeve që presin radhën e gjykimit me vite.

Ndërkohë, në Kodin e Procedurës Civile në nenin 399/2, pika 1(d) parashikohet afati i arsyeshëm 6 muaj -1 vit për gjykimin e çështjeve penale në Gjykatën e Apelit.

⁴ Neni 34/a

1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë:

a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;

b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;

c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;

d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;

dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson;

e) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;

ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;

f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij;

g) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit;

gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letërën e të drejtave në formë të shkruar.

3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

...d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.”

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

Neni 6 i KEDNJ-së⁵ zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një gjykim i drejtë në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elemente të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve etj.

Në Kodin e Procedurës Civile të RSH, ashtu si disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar.

⁵ Sipas nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të KEDNJ-së:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkojë nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo padi mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet konsideruar me efekt parandalues, në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit, pra që çdo individ ka një mjet efikas që do t'i vijë në ndihmë.

III. Vlerësimi dhe rekomandime

Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se sistemi gjyqësor, e veçanërisht Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, përballet me një numër tepër të lartë të çështjeve për trajtim dhe numër të ulët të gjyqtarëve, vetëm 31 gjyqtarë nga 78 që duhet të jenë sipas organikës. Evidentojmë se edhe problematikat vijnë për shkak të ngarkesës së tejskajshme të punës me të cilën po përballen gjyqtarët. Ky numër i kufizuar gjyqtarësh mbulojnë çështjet e ankimuara nga gjithë gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm të të gjithë vendit.

Shqipëria është ende larg mesatares evropiane për numër gjyqtarësh për 100.000 banorë⁶, vetëm 9.85 gjyqtar/100 mijë banorë krahasimisht me normën evropiane 22,2 gjyqtarë për 100.000 banorë.

Avokati i Popullit vlerëson se mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Sipas nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet shpehimisht kompetenca e gjyqtarit për caktimin e datës dhe orës së gjykimit të çështjes:

“1.Gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short.

2.Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin për rishqyrtim në këtë gjykatë.

3.Gjyqtari relator i çështjes urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë.”

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar edhe “Strategjinë kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” 2024-2027”⁷, por është i domosdoshëm zbatimi me efikasitet i saj dhe bashkëpunimi i të gjithë aktorëve për realizimin e objektivave të synuar.

Këshilli i Ministrave me VKM nr.787, datë 18.12.2024 miratoi “Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të planit të saj të veprimit si dhe të pasaportës së treguesve”, e cila synon të konsolidojë reformat e mëparshme dhe të harmonizojë sistemin e drejtësisë dhe ta afrojë atë me

⁶<https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

⁷ <https://klgj.al/strategjia-e-uljes-se-numrit-te-ceshtjeve-te-prapambetura-2024-2027/>

standardet më të mira të BE-së. Objektivat e saj janë arritja e rezultateve të prekshme lidhur me Reformën në Drejtësi, si konsolidimi i arritjeve të reformës, garantimi i pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, cilësisë në drejtësi dhe efikasitetit. Gjithashtu, një nga objektivat kryesorë është ulja dhe eliminimi i backlog-ut në gjykata.

Sjellim në vëmendjen tuaj, se kohët e fundit GJEDNJ-ja ka konstatuar në shumë raste të çështjeve me individë të ndryshëm kundër shtetit shqiptar se është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Konkretisht, në çështjet **Papakostandini kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 7568/08)⁸ dhe **Fortuzi kundër Shqipërisë** (kërkesa nr.29237/18)⁹, GJEDNJ shprehhet që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

E drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme¹⁰.

Kohëzgjatja e gjykimit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi¹¹. Në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi¹², pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse¹³.

Çmojmë se gjykimi i çështjeve në kohë dhe afat të arsyeshëm nevojitet të adresohet.

Po ashtu, mosshqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka çuar në pasoja të rënda për ankuesin. Vetë ankuesi, z.F.O është i papunë dhe familja e tij përballen edhe me vështirësitë financiare të përballimit të jetesës.

Në rastin objekt shqyrtimi, kemi një zgjatje të procedurave prej më shumë se 4 vitesh të çështjes penale në Gjykatën e Apelit nga data e regjistrimit të saj në gjykatë. Kjo është vonesë e theksuar, ndaj vlerësojmë të rëndësishëm respektimin e parimit, sipas së cilit gjykata duhet të realizojë një

⁸<https://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

⁹<https://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

¹⁰ https://www.gjk.gov.al/web/udherrefyesi_guida_gjk_2705.pdf

¹¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 17.02.2022

¹² https://www.gjk.gov.al/web/udherrefyesi_guida_gjk_2705.pdf

¹³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.2, datë 17.02.2022

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 11.05.2023

gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm **brenda një afati të arsyeshëm, për të garantuar kështu të drejtat e qytetarëve.**

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”,* si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e Popullit”,* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:*

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të nevojshme nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për respektimin e afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes penale me të pandehur F.O, me objekt “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik” dhe “Shkatërrim prone”, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”,* i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V